



SYLLABUS I LËNDËS “PRODHIMI PYJOR”

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	Fakulteti i Shkencave të Jetares dhe Mjedisit		
Titulli i lëndës:	Prodhimi pyjor		
Programi:	Shkencat e Pyjeve dhe Mjedisit		
Niveli:	Bachelor		
Statusi lëndës:	Zgjedhore		
Viti i studimeve:	Viti i dytë, Semestri i dytë		
Numri i orëve në javë:	2+1		
Vlera në kredi – ECTS:	3		
Koha / lokacioni:	Do shpallet		
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Asoc.Dr. Mirvjena Kellezi		
Të dhënat kontaktuese:	mirvjena.kortoci@uni-prizren.com		
Përshkrimi i lëndës:	<p>Kjo lende informon studentet mbi bazat e rritjes së pyjeve, kushtet e mjedisit. Rrezatimi, temperatura, uji, ajri dhe përmbajtja me lëndë ushqyese. Modelimi i kushteve të mjedisit. Ndarja e vegjetacionit në Evropë. Zonat fitoklimatike dhe tipet e pyjeve në Kosovë. Bonitimi i stacioneve pyjore. Grumbulli pyjor si mjet bonitimi. Struktura e grumbujve pyjore. Rritja e grumbujve të thjeshtë një moshare. Modele zonale të prodhimit. Rritja e drurëve individuale. Modele të drurëve përfaqësues të pavarur nga pozicioni i tyre në grumbull dhe të drurëve individuale të varur nga pozicioni i tyre në grumbull. Modelimi i ndërhyrjeve pyjore. Përshkrimi klasik i rrallimeve. Rrallimet në grumbujt e thjeshtë një moshare dhe në grumbujt e përzierë shumë mosharë.</p>		
Qëllimi i lëndës:	<p>Studenti duhet të njihet me bazat e rritjes së pyjeve, faktorët fizikë, zonat e vegjetacionit evropian, rrallimet, modelet e rrallimeve të pyjeve etj.</p>		
Rezultatet e të nxënit:	<p>Me përfundimin e këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje që:</p> <ul style="list-style-type: none">• Të njohin kushtet mjedisore të rritjes së pyjeve.• Të dinë tipet e pyjeve të Kosovës.• Të njohin modelet zonale dhe rritjen e drurëve individual.• Të dinë për strukturën e pyjeve dhe bonitimin e pyjeve.• Të dinë të bëjnë rrallimet dhe aplikimin e tyre në rritjen e prodhimit pyjor.		
Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30



Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në terren	-	-	-
Kollokfiume, seminare	-	-	-
Detyra të shtëpisë	-	-	-
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	5	5
Përgatitja përfundimtare për provim	1	5	5
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis,provim final)	1	5	5
Projektet, prezantimet ,etj	-	-	-
Totali			75 orë (3 ECTS)
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata, diskutime, ushtrime laboratorike, ekspedita konsultime, seminare, projekte të pavarura, detyra shtëpie, kolokviume, detyre kursi, provime.		
Metodologjia e vlerësimit:	Vlerësimi i parë (kolokvium): 15%, Seminaret ose angazhime tjera: 10%, Vijimi i rregullt: 5%, Provimi final: 70%, Total: 100%.		
Literatura			
Literatura primare:	<ul style="list-style-type: none"> Gadov, K.V. (1984). The relationship between diameter and diameter increment in Pinus patula. Proceedings of the IUFRO conference "Site and productivity of fast-growing plantations", held at pretoria 1984, Vol.2:741-751. Gadov, K.V. , Postoli A. Prodhimi pyjor- Skripte leksionesh per Fakultetin e Sjkencave pyjore. 		
Literatura shitesë:	<ul style="list-style-type: none"> James L. Bowyer, Rubin Shmulsky, John G. Haygreenjavascript:void(0): Forest Products and Wood Science: An Introduction, Balckwell, 2007. Mine V, Postolo A, Tabaku V. "Rrallimet Tregtare" 2002. 		

Plani i dizajnuar i mësimit:		
Java	Ligjërata	Ushtrime

<i>Java e parë:</i>	Bazat e rritjes së pyllit. Faktoret mjedisore. Rrezatimi djellor. Temperatura. Uji.	Ushtrime për llogaritjen e faktoreve ekologjike dhe ndikimit të tyre në rritjen e pyllit.
<i>Java e dytë:</i>	Ajri. Permbajtja në lende ushqyese. Modelimi i kushteve të mjedisit.	Ushtrime për llogaritjen e faktoreve ekologjike dhe ndikimit të tyre në rritjen e pyllit.
<i>Java e tretë:</i>	Bonitimi i stacioneve pyjore. Metodatat direkte të bonitimit. Grumbulli pyjor si mjet bonitimi. Bonitimi relativ dhe absolut i lartësive. Bonitimi në grumbujt shumë moshare. Metodatat indirekte të bonitimit. Toka.	Ushtrime për bonitimin e grumbujve pyjore.
<i>Java e katërt:</i>	Vegjetacioni, topografia, klima. Bonitimi nëpërmjet Remote Sensing dhe GIS. Krahasimi i metodave të bonitimit. Morfologjia e druveve pyjore. Kurora. Projektioni i sipërfaqes terthore të kurores nëpërmjet poligoneve, rratheve, funksionet Spline. Modelimi i profilit gjatësor të kurores.	Detyrë kontrolli. Bonitimi i stacioneve pyjore.
<i>Java e pestë:</i>	Dendësia e grumbullit. Dendësia e grumbullit në kuptimin klasik.	Ushtrime për morfologjinë e druveve pyjore.
<i>Java e gjashtë:</i>	Vlerësimi i konkurrencës së druveve individuale pa pozicion të njohur në grumbull. Metodatat e identifikimit të druveve konkurente.	Ushtrime për dendësinë e grumbullit.
<i>Java e shtatë:</i>	Vlerësimi i konkurrencës së druveve individuale me pozicion të njohur në grumbull.	Ushtrime për vlerësimin e konkurrencës së druveve individuale pa pozicion të njohur në grumbull dhe metodatat e identifikimit të druveve konkurente.

<i>Java e tetë:</i>	Struktura hapësimore e grumbullit. Modelet e shpërndarjes hapësimore të drurëve pyjore. Diferencimi. Koeficienti i variacionit të diametrave dhe lartësive të drurëve. Diferencimi i diametrave. Shpërndarja e lartësive tek (n) druret komshi.	Ushtrime për vlerësimin e konkurrencës së drurëve individuale me pozicion të njohur në grumbull.
<i>Java e nëntë:</i>	Pasuria llojore dhe diversiteti i specieve. Perzjerja e llojeve. Indekset e perzjerjes dhe ndarjes së llojeve.	Detyrë kontrolli: Dendësia e grumbullit. Ushtrime për strukturën hapësimore të grumbullit.
<i>Java e dhjetë:</i>	Rritja e grumbujve të thjeshtë në moshare. Modele zonale prodhimi. Funksione të thjeshta matematike prodhimi. Tabelat normale të prodhimit. Modele matematike të prodhimit.	Ushtrime për strukturën hapësimore të grumbullit.
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Modele të rritjes së grumbujve të varur nga dendësia. Marrëdhëniet midis dendësive së grumbullit dhe rritjes.	Ushtrime për strukturën hapësimore të grumbullit.
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Rritja e drurëve individuale. Modelet e pavarura nga pozicioni. Modelimi i rritjes në diametër, sipërfaqe bazimetrike, lartësi, etj. Modelet e varura nga pozicioni.	Ushtrime për rritjen e grumbullit. Ushtrime për rritjen e drurëve individuale.
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Riprodhimi simulativ i pozicioneve të drurëve.	Shembuj modelesh rritjeje të varur nga dendësia.
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Modelimi i nderhyrjeve pyjore. Përkrahimi klasik i rrallimeve. Tipi, intensiteti dhe periodiciteti i rrallimeve.	Shembuj modelesh të varur nga pozicioni i drurit në grumbull. Vlerësimi i rritjes në lartësi



		te drureve individuale dhe rritjes aktuale dhe potenciale ne diameter.
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Pershkrimi i rrallimeve ne grumbujt e thjeshte nje moshare me dhe pa pozicion te njohur te drureve ne grumbull.	Ushtrime per modelimin e nderhyrjeve pyjore.
Politikat akademike dhe kodi i sjelljes		
Studentët janë të obliguar në vijimin e rregullt në ligjërata, marrin pjese ne vizita studimore ne terren(ekskursion). Shkyçja e telefonave celularë, hyrja me kohë në sallën e mësimit dhe mbajtja e qetësisë në mësim po ashtu janë obligative.		